VENDIM
Nr.274, datë 10.5.2006

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, JOPUBLIKE "SEVASTI&PARASHQEVI QIRIAZI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Sevasti&Parashqevi Qiriazi", me seli qendrore në Tiranë, Kodër Kamëz.

2. Shkolla e lartë universitare, jopublike "Sevasti&Parashqevi Qiriazi", do të ketë Fakultetin Ekonomik, me degët:

- Menaxhim biznesi (4 vite);
- Drejtues finance (4 vite);
- Drejtues kontabiliteti (4 vite).

3. Në mbarim të ciklit të parë të studimeve, të cilat do të zgjasin 4 vjet, shkolla e lartë universitare, jopublike "Sevasti&Parashqevi Qiriazi" do të japë diplomë universitare "Bachelor", në titujt:

- Menaxhim biznesi;
- Drejtues finance;
- Drejtues kontabiliteti.

4. Shkolla e lartë universitare, jopublike "Sevasti&Parashqevi Qiriazi" do të fillojë veprimtarinë në vitin akademik 2006-2007 dhe do të ketë sistemin e studimeve me dhe pa shkëputje nga puna.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës të kryejë procesin e vlerësimit dhe të akreditimit të kurseve të studimit dhe të ndjekë zbatimin e ligjshmërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha